



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 417 Prot.

Tiranë, më 3 / 3 /2017

VENDIM

Nr. 45, datë 3 / 3 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_ në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankimin nr. 1395 Prot., datë 05.12.2016, ndaj Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/ Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, me shkresat e datës 12.10.2016 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion si më poshtë:

*Në lidhje me shkresën nr.180/16prot:*

1. Cilat janë shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë dhe standartet për cilësinë e shërbimit;
2. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
3. Cilat janë mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
4. Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato;
5. Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.

*Në lidhje me shkresën nr.181/16prot:*

1. Kopje të strukturës organizative;
2. Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit;
3. Kopje të strukturave të pagave për nëpunësit e tjerë;
4. Kopje të Rregullores së Brendshme të institucionit.

*Në lidhje me shkresën nr.182/16prot:*

1. *Kopje të planeve strategjike të punës;*
2. *Kopje të buxhetit për vitin 2015-2016;*
3. *Kopje të planit të shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet e kaluara për periudhën 2014-2016;*
4. *Kopje të dokumenteve që përmbajnë tregues të performacës së autoritetit;*
5. *Cilat janë mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik;*
6. *Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera;*
7. *Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
8. *Cilat janë mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

*Në lidhje me shkresën nr.183/16prot:*

1. *Sa është numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i është dhënë subjektit kërkuar;*
2. *Cilat janë informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh në institucionin tuaj.*

Autoriteti Publik, i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. 15075 Prot., datë 28.10.2016 duke dhënë informacione të përgjithshme dhe jo shteruese mbi pikat e kërkesave të ankuesit. Për këtë arsye ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim.

Në këto kushte ky i fundit kërkon nga Komisioneri, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoriteti Publik për të dhënë informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

Pas shqyrtimit të ankesës, dhe administrimit të provave Komisioneri konstaton se, pretendimi i ankuesit është i drejtë dhe se nuk është vendosur në dispozicion të kërkuarit informacioni si më poshtë vijon:

1. *Në lidhje me shkresën nr. 180/16prot: "Një përshkrim i thjeshtë ui sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; Cilat janë mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;"*

2. *Në lidhje me shkresën nr. 182/16prot: "Kopje të buxhetit për vitin 2015-2016; Kopje të planit të shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet e kaluara për periudhën 2014-2016; Cilat janë mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik; Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera; Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;"*

3. *Në lidhje me shkresën nr. 183/16prot: "Sa është numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke*

*vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i është dhënë subjektit kërkuar:  
Cilat janë informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh në institucionin tuaj”*

Në bazë të nenit 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” informacioni i kërkuar nga Qendra Res Publica bën pjesë në atë kategori informacioni që duhet të bëhet publik pa kërkesë.

Në këto kushte, në lidhje me ankimin e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’.

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankimit të Qendrës “Res Publica”, Nr. 1395 Prot., datë 05.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/“Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Drejtoria së Vendore e Policisë Tiranë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar (shkresa nr. 180/16 Prot., pika 2, 3 dhe 4; shkresa nr. 182/16 Prot., pika 2, 3, 5, 6 dhe 7, shkresa nr. 183/16 Prot., pika 1 dhe 2, datë 12.10.2016), brenda datës 10 . 3 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palëti kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot me datë 3 . 3 .2017.

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**  
